



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 08.08.2025

Numër Protokoll: 5310/2025

A.nr.905/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.905/2025, të datës 16.05.2025, të parashtruar nga ankuesja Q.K ,kundër organit të punësimit: Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në çështjen juridike “*Kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 08.08.2025, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i filluar sipas me numër A.nr.905/2025, e datës 16.05.2025, e parashtruar nga ankuesja Q.K.

A r s y e t i m

Kandidatja për pranim në shërbimin civil, Q.K (*në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesja*), me datë 16.05.2025, përmes emailit ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër vlerësimit lidhur me procedurën e pranimin sipas konkursit Nr. Reference RN00016679 për grupin e administrimit të përgjithshëm, për pozitën Zyrtar Administrativ, i shpallur nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, me datën 23.05.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (tutje MMPHI), ndërsa kjo e fundit me datë 27.05.2025, ka dorëzuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë, ka konstatuar se janë përmbushur kushtet për përfundim të procedimit administrativ të filluar sipas ankesës A.nr.905/2025, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës, Kolegji i Këshillit, ka gjetur se MMPHI, më datë 11.02.2025 ka shpallur Konkursin me Nr. Reference: RN00016679, për Grupin e Administrimit të Përgjithshëm, për pozitën e punës “Zyrtar Administrativ”, numri i kërkuar tre (3) pozita, klasa e pozitës profesional 3, me afati aplikimi nga data 12.02.2025 deri më datë 13.03.2025.

Tutje, nga shkresat e lëndës rezulton se në këtë konkurs kanë aplikuar 183 kandidatë, mesin e tyre edhe ankuesja, ndërsa sipas njoftimit të datës 28.03.2025, fazën e verifikimit paraprak e kanë kaluar 69 kandidatë mesin e tyre edhe ankuesja.

Pas përfundimit të procedurës, Divizioni i Burimeve Njerëzore në MMPHI, më datë 29.04.2025, ka publikuar njoftimin për kandidatin fitues për këtë pozitë, me tre kandidat fitues: G.D me 77.8 pikë, F.B me 77.6 pikë dhe A.P me 72.6 pikë, ndërsa sipas formularit të renditjes përfundimtare të kandidatëve ankuesja ka marr 70 pikë.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, pretendon se ka pasur parregullsi gjatë procesit, për shkak se vlerësimi i intervistës ka qenë subjektiv, ngase CV-ja nuk është vlerësuar në mënyrë të drejtë. Në ditën e testit ky proces është vonuar për 4-5 orë, nuk janë kontrolluar letërnjoftimet, intervista me gojë ishte e paraparë në orën 10:10 ndërsa është mbajtur në orën 11:15 dhe njëri nga anëtarët e komisionit gjatë intervistës ka qenë duke biseduar me telefon për rreth 5 minuta dhe është shkurtuar koha e për të dhënë përgjigje. Kërkon që ankesa të aprovohet.

Bazuar në të dhënat e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, rezulton se kandidati D.R, si kandidat aplikues në procedurën e rekrutimit me Nr. Reference: RN00016679, për Grupin e Administrimit të Përgjithshëm, për pozitën e punës “Zyrtar Administrativ”, kishte parashtruar ankesë në Këshill, kundër procedurës së njëjtë, ndërsa, Këshilli me Vendimin me numër A.nr.940/2025, të datës 04.08.2025, ka anuluar në tersi procedurën e pranimit sipas konkursit Nr. Reference: RN00016679, për Grupin e Administrimit të Përgjithshëm, për pozitën e punës “Zyrtar Administrativ”.

Andaj, referuar gjendjes se fakteve si më lartë dhe duke marrë parasysh se objekti i kontestit sipas ankesës A.nr.905/2025, të datës 16.05.2025, ka të bëjë me procedurën e pranimit për të cilën Këshilli ka vendosur në mënyrë meritore me Vendimin A.nr.940/2025, të datës 04.08.2025, rrjedhimisht ka anuluar procedurën e pranimit sipas konkursit Nr. Reference: RN00016679, atëherë mbi bazën e këtyre rrethanave, e në kuptim të dispozitave të nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative më të cilat është përcaktuar se: “*Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kot*”. Kolegji vlerëson së objekti i ankesës A.nr.905/2025, është bërë i pamundur për shqyrtim dhe vendosje.

Kështu që, në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi që të përfundoj procedimin administrativ të filluar me ankesën A.nr.905/2025, të datës 16.05.2025.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.905/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses Q.K;
- Organit të punësimi: Sekretarit të Përgjithshëm dhe Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në MMPHI; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.